

Monitorimi profesional dhe integral i APPA-s në buletinin Maj 2016

Nga Eva Leka

Audituese, KLSH

Qëllimi i organizatës jofitimprurëse “Platforma Shqiptare për Advokimin e Politikave” (Albanian Platform for Advocacy Policy), si pjesë e shoqërisë civile, që *kërkon prej të ardhmes, një vend të zhvilluar i cili ia del të menaxhojë pozitivisht asetet e veta dhe te investojë më shumë potencialet që ka*, shpreh më së miri qasjen e secilit prej kontribuesve të buletinit të muajit Maj 2016.

Dëshira e tyre e mirë për të pasur një vend i cili qeveris sipas konceptit të së drejtës dhe të mirës së gjithsecilit tregohet në qasjen e organizatës për të mbuluar me analiza çdo aspekt qeverisës dhe social të vendit. Energjitë e tyre janë përqendruar në të gjitha problemet sociale, ekonomike, politike që janë shfaqur në media kryesisht gjatë periudhës Maj 2016, por jo vetëm.

Të gjitha çështjet e trajtuara në buletinin APPA të muajit Maj, janë pika të trajtuara gjërësisht nga rrjeti mediatik i vendit. Buletini synon t’i përmbahet në thelb edhe misionit të vetë organizatës si *platforma e profesionistëve të rinj, të cilët monitorojnë dhe vlerësojnë politikat publike dhe aktivitetin e qeverisë duke ofruar gjithashtu zgjidhje alternative*.

APPA synon ofrimin për publikun një analizë kompetente dhe të pavarur rreth aktivitetit, proceseve dhe politikave që qeveria ndërmerr. *Të udhëhequr nga fryma e drejtësisë sociale dhe e dialogut, APPA heton aftësinë e institucioneve publike për t’i shërbyer dhe zgjidhur nevojat qytetarëve të vet*. Në përmbushje të misionit të organizatës, secili anëtar gjykon mbi çështjet e veçanta sipas profilit të vet të studimeve apo eksperiencave profesionale në fushat përkatëse.

Grumbullimi dhe trajtimi i problemeve fillon nga burimet zyrtare të institucioneve përkatëse, përgjegjëse ose jo drejtpërdrejtë, dhe nga rrjeti mediatik, kryesisht i shkruar dhe elektronik.

Kjo qasje e identifikimit të problematikave të mundshme nëpërmjet burimeve zyrtare, është qasja më e aksesueshme dhe e vlefshme individuale për secilin qytetar. Në këtë këndvështrim, trajtimi i çështjeve nga qytetarë aktivë, siç janë anëtarët e kësaj organizate, me rëndësi për publikun, është qasja e duhur sepse çdo individ i këtij vendi bazohet në informacionet që merr nga titullarët apo përfaqësuesit e institucioneve publike dhe media, për të gjykuar mbi efektet e çdo lloj politike, startegjie apo vendimmarrje.

Bazuar në metodologjinë e grumbullimit të të dhënave mbi problemet që trajton buletini, ekziston një pikë kontakti me një nga qasjet e identifikimit të çështjeve për auditim nga Departamenti i Auditimit të Performancës të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në këtë mënyrë, përgjithësisht shqetësime të ngritura me të drejtë nga APPA në rolin e shoqërisë civile, janë të rëndësishme për t’u parë me kujdes nga audituesit e performancës për të identifikuar çështje të reja auditimi.

Në buletinin e muajit Maj 2016, vihet re se një pjesë e mirë e tematikave që trajtohen janë çështje që Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucioni suprem i auditimit publik ka përqendruar vëmendje dhe energji. Çështje kyçe janë nën auditim apo audituar më parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Këtu mund të përmenden: Borxhi publik, Trashëgimia Kulturore, Mbrojtja e fëmijëve, Manaxhimi i mbetjeve, Sistemi shëndetësor, etj.

Shqetësimet që nga APPA mbulojnë pothuajse çdo fushë veprimi ekonomike, sociale e politike, ndër të cilat në buletin përmenden: Rritja e vazhdueshme e nivelit të borxhit publik, pronat private dhe mënyra e dëmshpërblimit të pronarëve, reforma në arsimin e lartë dhe tenderi i MASH për të marrë ekspertë ligjorë të cilët duhet të krijojnë 50 akte nënligjore për institucionin, problemet e ndryshme organizative në trajtimin e pronësisë të tokave bujqësore, kohëzgjatja e lartë e proceseve gjyqësore në gjykatat e vendit, rritje e kriminalitetit, rënia e rritjes ekonomike dhe mosrealizimi i rritjes së planifikuar, mos realizimi i Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve dhe Strategjisë Kombëtare të Manaxhimit të Mbetjeve, mosplotësimi i parashikimit të Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës në uljen e aksidenteve rrugore në masën 20%, etj.

Është për t'u vlerësuar kontributi dhe përpjekja e organizatës për të qënë sa më kritike dhe korrekte ndaj realizimit të planeve të qeverisë. Problemet e identifikuara dhe të ngritura, përfshijnë një sferë të gjerë të politikave ekonomike e sociale.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qënë gjithnjë i vëmendshëm në rritjen e bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile dhe organizata të profesionistëve në fushën e ekonomisë, duke nënshkruar kështu 22 marrëveshje bashkëpunimi, prej të cilave ka patur rezultate konkrete. Një nga këto marrëveshje është edhe ajo e nënshkruar në Prill 2016 me organizatën jofitimprurëse “Platforma Shqiptare për Advokimin e Politikave”. Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj, vlerësoi seriozitetin dhe ambicien e kësaj organizate, që përbëhet nga të rinj të moshës 18-30 vjeç, të cilët me vendosmëri dhe guxim kanë hyrë në tregun shqiptar të ideve, duke u ndjekur me interes nga publiku dhe duke ndikuar në rritjen e llogaridhënies dhe të transparencës së veprimtarisë së institucioneve publike.

Buletini i APPA u shpërnda tek të gjithë audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Drejtorët e departamenteve dhe të drejtorive analizuan me kujdes me stafin e tyre, materialin në temat që u përkasin departamenteve respektive. Po planifikohet të zhvillohet në të ardhmen një workshop mes KLSH dhe APPA, prej të cilës priten të gjenerohen rezultate të frytshme mbi identifikimin e problematikave më shqetësuese të shoqërisë civile.